



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA DURRËS  
KËSHILLI BASHKIAK

**PROCESVERBAL**

**Nr. 8, datë 24.09.2024**

**I mbledhjes së Këshillit Bashkiak Durrës që zhvillohet në sallën e Këshillit Bashkiak**

Orari i fillimit të mbledhjes : 14:15

Data e mbajtjes së mbledhjes : 24.09.2024

Mbajtja e mbledhjes : Salla e Këshillit Bashkiak

Lloji i Mbledhjes: Mbledhje Jashtë Radhe

**Përfaqësuesit e Bashkisë Durrës:** Kryetarja e Bashkisë znj. Emiriana Sako, si dhe përfaqësues të drejtorive, që kanë përgatitur materialet për mbledhjen plenare.

**Ani Dyrmishi:** Përshëndetje të gjithëve.

Të nderuar Këshilltarë ! E nderuar Kryetare!

Deklaroj të hapur këtë mbledhje jashtë radhe për Këshillin Bashkiak Durrës. Kjo mbledhje, është kërkuar, nga kryetarja e Bashkisë. Materialet ju janë vënë në dispozicion nga Sekretaria e Këshillit në rrugë elektronike. Ftoj sekretaren e këshillit të bëj prezencën.

**Dorina Milja:** Përshëndetje ! Fillojmë.

Ardian Muka ... Prezent .....deri tek.... Florian Tahiri...Mungon

34 Këshilltarë në sallë .

**Ani Dyrmishi:** Meqë kuorumi është i pranishëm, vazhdojmë me mbledhjen.  
Po kaloj në leximin e pikave të rendit të ditës.

Pika 1. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E DETAJIMIT TË FONDEVE TË ALOKUARA NGA BUXHETI I SHTETIT PER EFEKT TE RRITJES SË PAGAVE TË PUNONJËSVE MËSIMORË DHE TË PUNONJËSVE TË TJERË JOMËSIMORË NË INSTITUCIONET ARSIMORE DHE NË INSTITUCIONET PLOTËSUESE TË SISTEMIT ARSIMOR PARAUNIVERSITAR, SI DHE TË PUNONJËSVE TË SHËRBIMIT TË MBROJTJES NGA ZJARRI DHE SHPËTIMIN
Pika 2. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË BASHKËPUNIMIT MIDIS ASHK-SË DHE BASHKISË DURRËS PËR PËRFUNDIMIN E PROCESVEVE KALIMTARE TË PRONËSISË DHE TË TRAJTIMIT ME PRIORITET TË PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE TË PAPËRFUNDUARA PËR LEGALIZIMIN E NDËRTIMEVE PA LEJE NË ZONAT ME PRIORITET ZHVILLIMI URBAN DHE ZONAT INFORMALE TË BANIMIT NË BASHKINË DURRËS

**Ani Dyrmishi:** Përsa i përket rendit të ditës kemi ndonjë koment?

Komente nuk ka. Kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të rendit të ditës?

Kundra?.....

Abstenim? .....Nuk ka.

*Atëhere, me 34 vota pro, miratohet rendi i ditës.*

- Kalojmë në **pikën 1**. I japim fjalën Komisioni i Buxhetit, Financës dhe Taksave - Tarifave z. Xhelilaj.

**Rolant Xhelilaj:** Në komision pika e parë kaloj në unanimitet nga të gjithë pjesëtarët e komisionit.

**Ani Dyrmishi:** Faleminderit z.Xhelilaj.

Ndonjë koment përsa i përket pikës së parë?

**Dritan Burgija:** Një pyetje kam.

**Ani Dyrmishi:** Po zoti Burgija.

**Dritan Burgija:** Përshëndetje të gjithëve njëherë. Uroj t'i keni kaluar pushimet mirë.

Parashikohet këtu për edukatorët, punonjësit arsimorë, punonjësit e Qëndrave Kulturore të Fëmijëve, shërbimet mbështetëse dhe sekretarët e shkollave, janë përfshirë në skemën e rritjes së pagave apo janë hequr? Në qoftë se janë harruar domethënë, mendoj.....

**Emiriana Sako :** Cilat?

**Dritan Burgija** : Shërbimet mbështetëse domethënë, që janë nëpër shkolla dhe sekretarët e shkollave.

**Emiriana Sako**: Në këtë material kemi futur ato palë që janë përcaktuar nga ministria për të cilat janë miratuar fondet dhe buxheti është miratuar për këto. Specifikisht për sekretarët nuk kthej dot përgjigje. Njëherë këto që janë përmendur këtu janë të gjitha, hap pas hapi VKM-ja ka ndryshuar për të gjithë administratën e bashkisë, por për këto janë transferuar fondet.

**Dritan Burgija** : Po e kuptoj, por mbase është harresë.

**Emiriana Sako**: Jo harresë, por unë nuk them përgjigjen dot tani për sekretarët e shkollave.

**Dritan Burgija** : E shtrova si çështje.

**Ani Dyrmishi**: Z. Gurra, po.

**Ardian Gurra** (*Drejtor i DRKA dhe KF*) : E ke në krye të lëndës të shkruar.

**Ani Dyrmishi**: Përfshihet aty sekretari shkollave?

**Ardian Gurra** : Sistemin po, sistemin parauniversitar, jo parashkollor parauniversitar, të gjithë sistemin ndihmës ku hyjnë dhe sekretarët dhe sanitarët.

**Emiriana Sako**: Sekretarët e shkollave?

**Ardian Gurra** : Po shkollave, shkollave.

**Ani Dyrmishi**: Përshihet domethënë ?

**Ardian Gurra** : Po përfshihen.

**Ani Dyrmishi**: Dakord.

Atëherë pyetje tjetër?

Nuk ka.

Kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 1?

Kundra?.....

Abstenim? .....Nuk ka.

Atëhere, me 34 vota pro, miratohet pika e parë e rendit të ditës.

- Kalojmë **në pikën 2**. I japim fjalën Komisionit të Rregullores, Çështjeve Juridike, znj.Devolli.

**Edlira Devolli:** Faleminderit Kryetar.

Komisioni u mblodh dhe pasi e shqyrtoi çështjen vendosi ta kaloj për votim.

**Ani Dyrmishi:** Faleminderit.

Pyetje përsa i përket pikës së dytë të rendit të ditës?

**Ardian Muka:** Po.

**Ani Dyrmishi:** Po z.Muka.

**Ardian Muka:** Mirëdita.

Qëllimi i këtij akti ligjor është që ASHK-ja dhe Bashkia, siç thuhet dhe në këtë relacion, sipas ndarjes territoriale, të bashkëpunojnë dhe bashkërendojnë veprimtarinë administrative, në kuadër të trajtimit me prioritetet etj etj.....

Unë kisha dy pyetje. E para në bazë të kujt ligji do të vazhdohet të procedohet? Pra, dikush që e ka plotësuar dokumentacion në vitin 2004, ka kryer pagesën e tarifës së aplikimit, ka plotësuar të gjithë dokumentacionin dhe në bazë të atij viti, nëqoftëse do ishte trjatur në atë vit, normalisht duhet ta kishte marrë procedurën e legalizimit. Nëqoftëse sot, do hyjmë në llogjikën e 2024-ës shumë objekte të legalizimit do t'i vi siraja të mos legalizohen, sepse ashtu është koncepti, kanë ndryshuar rregullat, ka ndryshu ligji për urbanistikën, kanë ndryshuar shumë indikatorë, të cilët të caktojnë dhënien ose jo të lejes. Dhe pyetja ime është shumë e thjeshtë. Qytetari, i cili ka ndërtuar në pronën e tij, ka ndërtuar një objekt shtesë, po flas ka bërë një shtesë, si do procedohet? Në këtë pikë pyetja që unë ushtroj është: Për çfarë duhet bashkia, në çfarë na duhet ky lloj bashkërendimi që ne i kërkojmë ministrisë, kur të gjithë procedurën ne kemi kry, e kemi kry në kohën kur procesi ishte i hapur? Dhe sot kërkohet nga ana e bashkisë që ne të votojmë një bashkërendim ndërmejt ASHK-së dhe Bashkisë Durrës, pra kur është procedura e ligjshme, pyetja ime është proceduralisht : Çfarë do bëjë bashkia? Sepse dokumentacioni dhe gjithçka që ne e kemi kryer për një paaftësi të qeverisë, deri në atë kohë bashkia nuk ka qënë pjesë. Kemi 20 vjet që ne e tërheqim zvarrë këtë proces dhe në 2024-ën kërkojmë që t'i fusim një marsh shtesë meqenëse do vi 2025-sa dhe do na duhen vota. Megjithatë thashë duke ndarë pjesën politike veç, proceduralisht: Çfarë do bëj bashkia në këtë bashkërendim? Ta dinë qytetarët gjithë këtë procedurë.

**Emiriana Sako:** Faleminderit për pyetjen.

Në fakt qëllimi i këtij materiali që ne po kalojmë sot në Këshill, është bashkërendimi i punës dhe koordinimi, si dhe përcaktimi i zonave prioritare për procesin e legalizimit në bazë të studimeve apo planeve të zhvillimit që mund të ketë bashkia Durrësit. Nuk kemi rol në procesin ligjor që kryejnë institucionet përkatëse të ASHK-së pjesa e legalizimeve, pra bashkia nuk do marrë përsipër të kryejë procedurat, të cilat i takojnë tërësisht vendimmarrjes së ASHK-së në bazë të ligjit të 2020, të gjithë qytetarët që kanë aplikuar, pra nuk i hym fare procesit të vitit të aplikimit, periudhës së aplikimit, ne kemi për detyrë të evidentojmë problematikat. Duke qënë se në zyrat e bashkive vijnë qytetarë me probleme, që nuk u përkasin vetëm njësive vendore, është menduar

nga ana e qeverisë për të bashkërenduar punën institucioni vendor lokal me ASHK-n për të vënë në prioritet zonat e procesit të legalizimit.

Ne me këtë marrëveshje dhe me miratimin që bëmë më në mbledhjen e korrikut, ku u shtua buxheti për 20 persona, specialistë të cilët do të atashohen në institucionet e ASHK-së së Durrësit për të bërë në terren verifikimin e proceseve dhe matjet në rast se ka nevojë për matjet, e të tjera me radhë. Të gjitha njësitë administrative, sot që ne flasim janë të ngarkuar me punë në terren për evidentimin e familjeve, të cilat janë në proces legalizimi, kanë mbledh listat e personave, të cilët janë në proces dhe kanë dosjet e rregullta, le të themi që kanë procedurat e bëra, aplikimin e kanë realizuar brenda afatit kohor, në bazë të këtij materiali që ne do grupojmë, do t'ia transferojmë informacionin ASHK-së për të kryer ata procesin e legalizimit, pra procesin e dhënies së një përgjigjeje. Pra, realizimi i procesit të legalizimit, marrja e dokumentit ose kthimi i një përgjigjeje definitive që nuk bëhet procesi i legalizimit. Pra qytetarët do dinë në fund të këtij procesi që a do të shqyrtohen, do kenë përgjigje pozitive ose negative në bazë të legjislacionit patjetër. Marrëveshja parashikon së pari transferimin e fondit, pra fondin prej 20 vetash do ia transferojmë ASHK-së dhe ata do të bëjnë rekrutimin e stafëve përkatës dhe do të jenë në efikasitet të plotë me funksionet të plota si specialistë të ASHK-së. Kemi vënë dhe një opsion në marrëveshje që kjo do jetë në varësi të nevojave që do ketë ASHK-ja pastaj që inxhinierët, të cilët janë në Bashkinë e Durrësit, që janë të licencuar apo që janë në fushat, si staf të ASHK-së, të cilët i mungojnë mund të transferohen me kohë të pjesshme për të plotësuar nevojat, sepse Durrësi ka rreth 50 mijë dosje për proces legalizimi dhe stafi i ASHK-së sigurisht është në një proporcion shumë herë më të vogël për të mbuluar brenda afatit të vitit 2028 për të përmbyllur të gjithë procesin e legalizimit, pra ne duam që inxhinierët, të cilët janë sot në bashkinë e Durrësit, të transferohen në ASHK për të bërë procese, të cilat mund t'i bëjë kushdo inxhinier matjet në terren, verifikim në terren, gjetjen e pozicionit të banesës në zonë. Dhe për më tepër dhe ne kemi shtuar buxhetin, ndërkohë që ASHK do rekrutojë stafin prej 20 vetësh, se mund të ketë dhe ajo sfidën e vet, se të gjithë sot 20 inxhinier që të punojnë përnjëherë nuk është e thjeshtë pasi tregu i punës i kërkon sektori privat dhe nga ana tjetër do vejmë në dispozicion një grup inxhinierësh do të jenë atje derisa ata të rekrutojnë njerëzit e duhur për të bërë procesin.

Roli ynë për ta përmbledhur është koordinues dhe menaxhues përsa i takon orientimit të problematikave. Pra një qytetar kur të vij në zyrat e bashkisë në njësinë administrative dhe thotë unë kam procesin e legalizimit në proces, kam 2 vite, kam 3 vite apo kam 10 vite se mund të ketë që ka një periudhë shumë të gjatë kohore, ne e dimë që është sfidë procesi i legalizimit, është një proces kompleks dhe i vështirë, ndërkohë ligji nga ana tjetër kërkon që azhornimet të jenë të tre muajve të fundit. Pra një matje që është bërë në vitin 2014-2015 do duhet ribërë dhe të shifet sot fakti se si është i objektit, sepse një familje mund të ketë ndërtuar një banesë dy katëshe e ndërkohë ka bërë një kat të tretë apo një papafingo dhe nuk mund të merret legalizimi me dy katet e para, por duhet të azhornohet brenda tre muajve të fundit si pjesë e procesit ligjor të ASHK-së. Kështu që ky është qëllimi i marrëveshjes, ne kemi besim që do të ketë një efikasitet ky lloj procesi, edhe pse ne si bashki na ngarkon shumë, sepse kemi shumë ngarkesë për sektorin e projekteve dhe investimeve ku punojnë inxhinierët, të cilët ne sot i kemi në terren për të bërë evidentimin e zonave dhe familjeve, që janë në proces legalizimi. Por jemi në shërbim të komunitetit dhe për

këtë arsye kemi marrë impenjim maksimal që ta bëjmë këtë proces në bazë të VKM-së, që ka dalë dhe ka hy në fuqi vetëm disa muaj më parë dhe kësaj marrëveshjeje që miratojmë sot.

**Ani Dyrmishi:** Faleminderit.

Pyetje tjetër ?

**Ardian Muka:** Dhe një pyetje.

**Ani Dyrmishi:** Po. Pyetje shteruese.

**Ardian Muka:** E thënë shqip shqip me sa kuptova unë, nga ajo që tha zonja kryetare, është që ky proces nuk do jetë gjithëpërfshirës, pra do jetë i specifikuar, pra aty ku bashkia dhe qeveria do ketë planifikuar shërbime urbanistike a ku di unë, dhe qytetari Ardian Muka, i cili është në lagjen x, mund të mos jetë pjesë e këtij procesi, po e marrë që mos përmend emër të ndonjë qytetari tjetër, mund të mos jetë pjesë e këtij procesi, meç po kuptoj atë që juve e thatë. Kjo do bëj, akoma më shumë do krijojë një shkëputje ndërmjet çfarë janë interesi i qytetarëve dhe asaj që është interesi i qeverisë dhe bashkisë, duhet të jetë parasysh diçka, se kur themi që aty ku do ketë fonde dhe aty ku do ketë projekte për zhvillime infrastrukturore ose zhvillime urbanistike qytetarët rrezikojnë shumë që të marrin përgjigje negative. Këtë ta dini nga fillimi, dhe flas si specialist, që pavarësisht se ato mund të kenë 10 vjet, apo 20 vjet, apo 5 vjet duke bërë aplikim, në rastin ku do ketë zhvillim infrastrukturor në 90% të rasteve, siç e shoh, do kenë përgjigje negative, sepse natyrisht nuk i intereson bashkisë, nuk i intereson qeverisë të paguaj tek e fundit për ata që ok kanë bërë ndërtim abuziv, por ligji ka dhënë të drejtën që dhe ata ta legalizojnë.

Kaq ishin konstatimet, faleminderit.

**Emiriana Sako:** Kjo mënyrë nuk qëndron. Ne thamë që do fillojmë nga zonat prioritare, por procesi për 15 mijë dosje që ka Durrësi ka afat zyrtar për të përfunduar në 2028 dhe ne atë afat duam ta shkurtojmë ta çojmë brenda vitit 2026, që do të thotë që brenda vitit 2026 do të kemi të gjitha dosjet e shqyrtuara me përgjigje përfundimtare, miratuar ose jo miratuar.

Sa i takon, ky është aludim që ju thoni që nuk do futen në proces. T'iu jap një shembull programin e rindërtimit, ku të gjitha familjet që kanë qënë, qoftë qoftë edhe kanë pasur edhe një aplikim në proces legalizimi, janë marrë masa që të marrin banesë ose të marrin shpronësim nga ana e qeverisë shqiptare, pra asnjë rast nuk kemi pasur procedura të cilat....

*(ndërhyn Ardiani)*

Po të them që. . po pra po për tërmetin, po të ilustruj një shembull konkret që me rasin e tërmetit i kemi futur të gjithë në bazë të një akti normativ nr.9, patjetër, nuk është në vullnetin e bashkisë apo Këshillit Bashkiak kjo, janë përfshirë në procesin e rindërtimit dhe ata të cilët i është prishur banesa dhe e kanë pasur në proces legalizimi apo ata të cilët në rrugën Miqësia, u ndërtua rruga, e kishin në proces legalizimi për arsye të zgjerimit të rrugë, iu prish një dhomë apo një ballkon të gjithë janë rimbursuar ose financiarisht ose me sipërfaqe 1x1 në Zonën e Re. Kështu është, mund ta vërtetojnë edhe këshilltarët e tjerë që janë këtu.

**Ani Dyrmishi:** Faleminderit.

Ndonjë tjetër?

Po z.Burgjia.

**Dritan Burgjia:** Flas në emër të grupit. Na keni vënë përpara një marrëveshje, me afat 1 vjeçar, kryetarja tha që shpresojmë ta mbyllim deri në 2026, por projekti është për 2028, tani siç e mbaj mend, mbaj mend fushatën e 2013-ës, ku për partinë tuaj ky kal beteje “puna e legalizimeve”, ku Edi Rama foltore më foltore, firmosi kontratë me qytetarët, që thonte brenda mandatit të parë do legalizohen shtëpija, ndërtime pa leje, madje arriti deri aty sa tha që do bëhen legalizimet falas dhe natyrisht pati efektin e vet në ato palë zgjedhje.

Ne ikëm nga pushteti me shpresën që për qytetarët të ndodhte një gjë e tillë, të merrnin zgjidhje për këtë punë. Sot jemi viti 2024, pas 12 vjetësh që diskutojmë prapë proceset e legalizimeve dhe vimë në momentin që ju po kërkonte, pra dukshëm që po kërkonte, për efekt elektoral një vit kontratë me ASHK-në, doni t’i bëni njerëzit që të përplasen prapë në dyert e bashkisë, të vinë njerëzit te ju, mos të shkoni ju te njerëzit. Dhe natyrisht që na bën të mendojmë që është komplet për efekt elektoral dhe unë qëndrimin tim dhe të grupit po iu them që nuk jeni ju mas 12 vjetësh që mund ta zgjidhni problemin e njerëzve për çështjen e legalizimeve.

Çfarë ndodhi në 2013? Në 2013 pasi morët mandatin, jo që nuk legalizuat, nuk bëtë proces, por pamë vetëm prishje me fadroma, me eskavator dhe me tritol. I terrorizuat qytetarët me leje dhe pa leje, prandaj them që nuk jeni ju që e çoni dot përpara procesin e legalizimeve.

Në këtë kuadër, për të qenë të qartë, nuk jemi kundër që qytetari të marrë zgjidhje, që të bëjë legalizimin e ndërtimeve të veta se i ka bërë me gjak dhe me djersë, jemi kundra marrëveshjes tuaj dhe e shpreh sot votën kundra në emër të grupit.

Faleminderit, mund të ketë shumë kjo temë për të fol , por.....

**Ani Dyrmishi:** Po z. Myshketa.

**Jonuz Myshketa:** Përshëndetje znj. Kryetare ! Përshëndetje të nderuar kolegë!

Në disa pika bie dakord me kolegun parafolës, padashur të paragjykoj politikisht kërkënd, por mund ta them me bindje të plotë, siç jemi të gjithë dëshmitarë, që është një plagë e hapur tash 20 vite, e filluar që në 2006 me qeverinë e PD-së parë, ku ishim të gjithë së bashku, e cila nuk dha efekte të dëshiruara me lidhje me ç’ka u nis, e cila solli shumë raste korruptive dhe shumë persona të dërguar dyerve të gjykatës dhe prokurorisë në lidhje me abuzimin që u bë kundrejt qytetarëve për procesin e legalizimit. Por dy vitet e fundit, qeveria socialiste nuk e zgjidhi këtë çështje, e cila ishte nevralgjike, pavarësisht se personalisht kam qënë kundër një ligji, i cili nuk zgjidhte problemin e pronës, por zgjidhte problemin e legalizimeve, jo është për të gjitha rastet.

Uroj dhe dëshiroj që ky problem të zgjidhet njëherë e mirë, por jam skeptik, ajo ç’ka nuk u bë për 12 vite, të bëhet për një periudhë shumë të shkurtër kohore, dhe për më tepër jam dakord me ju zonja kryetare që bashkia nuk ka nevojë për ngarkesa të tepërta për ato halle dhe për ato çështje që ka për të zgjidhur bashkia e Durrësit. Prandaj mbetem shumë skeptik në lidhje me nismën e qeverisë, pa dashur të bëjë një ironi, më vjen mirë që qeveria gjatë gjithë këtyre centralizimeve, arrin të bëjë një decentralizim dhe të ketë një marrëdhënie me ligjet e qeverisë në bashkërendim

me bashkinë, por besoj se bashkia ka goxha për të bërë dhe ky problem nuk zgjidhet për një afat kohor shumë të shkurtër, kur të dyja pushtetet i kanë pasur në dorë për ta zgjidhur dhe nuk e kanë zgjidhur, madje mund ta kenë çuar në një situatë akoma më kaotike, ku njerëzit janë, nuk e di ku janë në lidhje me këtë proces edhe enden akoma dyerve të aluizmit të famshëm pa marrë një zgjidhje. Ju faleminderit.

**Ani Dyrmishi:** Z. Xhelilaj.

**Rolant Xhelilaj:** Faleminderit!

Desha t'i bëja një koment pretendimeve të zotit Muka dhe z.Burgija. Mbyllja fund e zotit Burgija më jep të drejtë të them që është refleksi i një situatë të vështirë që kanë kaluar në 2013, ato 1 milion shuplaka që edhe sot i djegin dhe në mënyrë të çuditshme e lidhin me faktin që thotë: Njerëzit kishin shpresë që direkt sa të vinte qeveria socialiste e Edi Ramës do legalizoheshin objektet e tyre ose ajo katrahurë që na la Partia Demokratike. Gjë që nuk është e vërtetë, njerëzit ishin komplet të mërëzitur dhe kundërshtues të politikës së ndjekur në ato vite të forcës tjetër politike dhe atë premtim nëqoftëse do e quajmë premtim e treguam dhe në 2017 dhe në 2021. S'ka lidhje fare. Këtu ka një gjë, një këndvështrim, është një proces i vështirë që koha tregoi që me të gjithë përpjekjet e ASHK-së, dikur aluizmi, efekti pozitiv tek njerëzit ka ecur me ritme jo në nivelin që duhet. Atëherë futja e bashkive në këtë proces shifet në dy drejtime. Drejtimi i parë është që bashkisë i shtohet një ngarkesë, edhe për faktin se qytetarët në përgjithësi e duan zgjidhjen nga pushteti vendor, në të njëjtën kohë e vë dhe ASHK-n në lëvizje me bashkinë dhe me ato njerëz që do rekrutohen dhe nga ASHK-ja, në bashkëpunim me bashkinë, për të qënë më koherent dhe më në gadishmëri për të dhënë përgjigje efektive për çdo kërkesë.

Numri i madh i dosjeve, që vazhdojnë të jenë, tregon domosdoshmërinë e një mase të tillë marrjeje nga qeveria socialiste, për mbylljen e këtij procesi brenda vitit 2028, përpjekjet tona janë ta bëjmë dhe më shpejtë. Ne punojmë për njerëzit, ata mundohen të bëjnë politikë. Politika në këtë rast nuk zë vënd, çdokush e shef efektin e gjësë që aprovohet, e projektligjit, projektvendimit apo e çdo lloj vendimi që merret në çdo instanc nga lart e deri tek pushteti vendor, në zbatimin në praktik dhe e reflekton në fushatat elektorale. Një vit më përpara qahesh për fushatën e shpejtë, do lodhen. Ne si grup parlamentar e mbështesim këtë projektvendim dhe kemi besim që me përpjekjen maksimale të bashkisë, po patjetër që dhe qeveria është e detyruar ta ndjeki këtë proces me vëmendje do të bëjmë të mundur realizimin e detyrës që është marrë përsipër brenda afatit 2028. Faleminderit!

**Dritan Burgija:** Një replikë të shkurtër.

**Ani Dyrmishi:** Po, zoti Burgija një replikë 2 minuta.

**Dritan Burgija.** Z.Xhelili jemi këshill bashkiak, se u drejtove grupi parlamentar, s'ka gjë, ka ngel ora atje, politika që bëhet atje po ....

**Rolant Xhelilaj :** Nuk ka ngel keq.. ..Faleminderit që ma kujtove.



**Dritan Burgija:** Uroj uroj që të kandidojnë prap.

**Rolant Xhelilaj :** Ishallah.

**Dritan Burgija:** Në çdo fjali, në çdo fjali.....

**Rolant Xhelilaj:** Mos ki merak. Shiko, shiko se unë nuk desha ta zgjas, por të lidhësh, legalizimin me zgjedhjet e 2013-s me premtime është stërmundim z.Burgija, është stërmundim. Problemet e qytetarëve janë të shumta, detyrat e qeverisë dhe pushtetit vendor janë të shumta dhe qytetari e shpreh bindjen me votë në zgjedhjet e pushtetit vendor apo dhe pushtetit qëndror, parlamenti. Meqë e ke merakun kjo është një lloj...

**Dritan Burgija:** Parlament i vogël.

**Rolant Xhelilaj:** Jo parlament i vogël, parlament i rëndësishëm, për qytetin e Durrësit dhe nëqoftëse përdorim një shprehje që hyn te parlamenti nuk bëjmë pjesë, por i rrisim vlerën të gjithëve që janë këtu edhe ty edhe mua, e të gjithëve që janë këtu që janë në këtë sallë, që bëjnë pjesë te Këshilli Bashkiak.

**Dritan Burgija:** Ishte një lapsus, përmendja e lapsusit ishte më tepër për të shkrirë pak akullin.

**Ani Dyrmishi:** Mbarove z. Burgija.

**Dritan Burgija:** Po ça mbarova, nuk fillova akoma.

**Ani Dyrmishi:** Po vazhdo.

Z.Xhelilaj të lutem mos e ndërprit.

**Dritan Burgija:** Në çdo fjali që përdore z.Xhelili më dhe të drejtën mua në ato që unë ngrita. Përmende pastaj, që unë nuk u futa, përmenda vetëm 2013, ju përmendet dhe 2017 dhe 2021. Në këto tre palë zgjedhje bashkë, fut dhe 2 palë zgjedhjet bashkiake keni ec me kalë beteje me legalizimet duke i marrë njerëzit, duke i shkuar nëpër shpija, duke i bo letrat, duke i firmos copat e zarfave tek oborri i shpisë.

Tani unë thashë që, nuk jeni më ju të besueshëm që mund ta çoni përpara këtë proces. Do uroja shumë që njerëzit të marrin zgjidhje, domethënë pas shumë vjetësh, ju pranoni, dhe fjalët tuaja, pranoni që ky proces nuk ka ec siç duhet, domethënë pranoni që gënjeshttrat e 2013, 2017 2021 janë të vërteta, ato që përmenda unë janë të vërteta. Dhe thoni, tashi po bëjmë një strukturë të re ne 6 muaj para zgjedhjeve që njerëzit do vikan te bashkia, do merrkan zgjidhje, një gjë që nuk u bë 12 vjet dhe do merrkan zgjidhje këtë vitin e fundit apo 6 muaj deri sa të vinë zgjedhjet.

Dhe pastaj mbarojnë zgjedhjet, i bje se e keni llogarit dhe kohën tamam me muaj, mbarojnë zgjedhjet dhe pastaj thua shiko mbaroj afati s'kemi më mandat. Kush e han më këtë? E kam për qytetarët, nuk e kam për replikë me ju këtë, unë e kam për.....

Unë kur flas këtu iu drejtohem qytetarëve të Durrësit. Meqë ju domethënë përmendni vota dhe mendoni që ne kemi hallin te votat, qytetarët të dëgjojnë ty, më dëgjojnë dhe mu. Shyqyr keni pas në dorë shumë për të bo për qytetarët, nuk e keni shfrytëzuar mundësinë që iu kanë dhënë me votë ashtu siç duhet, kështu që të paktën na kurseni ironinë, domethënë që juve zgjidhni këtë punë për 6 muaj. Faleminderit

**Ani Dyrmishi:** Zonja Kasa.

**Flutura Kasa:** Përshëndetje.

Jam një nga aplikueset e para, për procesin e legalizimit.

**Ani Dyrmishi:** Afroje pak mikrofonin, të lutem.

**Flutura Kasa:** Po, domethënë i bie 2005, 2006, më duket se këtë, Zyrën e Agjencisë së Legalizimit, është hapur në kohën e qeverisë Berisha, dhe meqënëse se po diskutohet që po bëhet para zgjedhjeve, t'i ua u çoj içik atë kujtesën, që në 2009, kanë dalë punonjësit e legalizimit të asaj kohe dhe na kanë marrë nga 40 mijë lekë të vjetra, dhe sot e ruj unë atë biletën, që s'më hyn në punë fare, po e ruj, më kupton. Dhe ajo atëhere u bo, që u diskutonte, që po mblidhen lekë për fushatë, në 2009 s'ka qënë qeveria Rama, kështu që po ta diskutojmë kështu, procesi i legalizimit atëhere...

**Ardian Muka :** Ajo ishte taksa e shërbimit ç'a lidhje ka...

**Flutura Kasa:** A ka mundësi ta mbaroj unë, ta mbaroj unë, pastaj ishalla jam gabim unë, po unë e ruaj ate faturën po deshe ta zmadhoj ta bi këtu, që kam lonë 40 mijë lekë të vjetra, gjë që për qytetarët në atë kohë, ka qënë shumë. Më kupton?

Prandaj mos të diskutohet, jo jena para zgjedhjeve, jo jena mrapa zgjedhjeve. Shyqyr që po bëhet kjo marrëveshja dhe ishalla shpresoj, që të shkojë deri në fund mirë, sepse sa herë shkoja te legalizimet për të kërku ndihmë thoshin nuk kemi njerëz shumë për në terren. Tashi që po i shtojmë njerëzit për në terren, del që qenka për fushatë. Kështu që mos përsëritni për të bo akuza për ato gjona që i keni bo ju vetë përpara.

**Ani Dyrmishi :** Z. Markola, pastaj znj. Musaraj.

**Hekuran Markola:** Faleminderit.

Sa për politikë kush janë të besueshëm do ta shohim në 2025-ën dhe do kemi kohë të flasim prapë këtu.

Unë kisha një pyetje konkrete nëse është e mundur, për kryetaren, që në marrëveshje të shtohet një pikë ose një nen, që të ketë një afat kohor për të shqyrtuar dosjet. S'ka rëndësi përgjigja po ose jo, sepse pa një afat kohor mu më duken se do zvarritet, e do zvarritet, e siç janë zvarritur. A është e mundur juridikisht?

**Emiriana Sako:** Afatet kohore janë përcaktuar në ligj. Ne kemi dashur që, kemi dashur që marrëveshja të jetë më gjithëpërfshirëse, dhe patjetër që me hartimin e dosjes dhe me plotësimin e tyre, stafi i ASHK-së, do ketë nga një person për të shqyrtuar rastet, sepse ne do të raportojmë paralel. Pra, Bashkia dhe ASHK-ja dhe Ministria e Shteti për autoritetet lokale, por edhe më tej dhe pranë Kryeministrit, zyrës së kryeministrit dhe më tej, rast pas rasti. Domethënë do vendosim një axhendë, pra do jemi përballë një objekti të përcaktuar mirë. Kështu që mendoj se nuk ka të bëjë me vendosje marrëveshjeje edhe sepse dosje të caktuara mund të kenë problematika komplekse qoftë regjistruesi, qoftë familjarët, shpeshherë ndodh që të regjistrohen sipas kateve, sipas kateve të familjarëve, vëllezërve dhe motrave, kështu që nuk kemi vendosur këto gjëra në marrëveshje, sepse janë të përcaktuara në ligj.

**Ani Dyrmishi:** znj. Musaraj.

**Jonida Musaraj:** Atëherë mua më duhet...

Përshëndetje të gjithëve! Unë po i përmend emrat e kolegëve të mi se mund të ketë dhe replikë më mbropa.

Së pari e kam me kolegun zoti Muka, është ekspert i fushës më shumë se unë, gjithsesi më duhet të sqaroj diçka pse është e nevojshme kjo marrëveshje. Së pari sepse bëhet fjalë zoti Muka për ndërtime pa leje të pastuduara dhe si e tillë zhvillimin urban në dijenin time nuk e bën ASHK-ja, gjithsesi qofsha gabim, dhe marrëveshja e bashkëpunimit kërkon bashkërendim të punës dhe jo mbivendosje kompetencash, sepse pashë në fjalimin tuaj kërkonit medoemos ku do ta gjejë zgjidhjen qytetari . Qytetari do ta gjejë zgjidhjen aty ku i takon ta gjejë zgjidhjen, nuk e jep ligji këtë, që e cakton do të shkojë ke bashkia apo do të shkojë ke ASHK-ja.

Dhe në lidhje me zotin Burgija do doja ti kujtoja, madje e kam sjellë me zë dhe me figurë, por i keni të gjitha në youtube, na keni akuzuar para disa vitesh, sidomos drejtuesin e asaj kohe të legalizimeve dhe kryeministrin, për një lumë legalizimesh për qëllime fushate, ndërsa sot dëgjoj nga ana juaj që ky proces është lënë pas dore dhe nuk po bëhet legalizimi. Do të kisha dashur nga ana juaj të jeni koherent mbi qëndrimet, këto akuza janë bërë nga ju, por edhe nga kolegët tuaj politik më lartë se ju.

Dhe së dyti, do doja të dija më saktë, të vija shpirtin në paqe që nuk jemi në fushatë sot, por jemi 4 vjet e 4 vjet, pra jemi gjatë gjithë kohës. Fakti që një forcë politike është gjatë gjithë kohës në fushatë nuk nënkupton që qytetarët të mos marrin shërbimin që i takon me pretendimin, që ju aludoni që pas 365 ditësh, që ne e kemi filluar fushatën ju jo, jeni turn off, mendohet që ky legalizim do t'i shërbejë marrjes së votës. Binduni sot, jo për t'ju demoralizuar e kam me sinqeritet këtë gjë, binduni sot që 2025-n nuk e keni, jo për fajin tonë, por për shkak të qytetarëve, është shumë e thjeshtë. Nuk mundet kurrsesi të manipuloni votat me një legalizim 2, 3, 10, 15, e keni gabim këtë preceptim dhe e keni gabim, e kam vënë re dhe në komisionet ku marr pjesë në çdo

vendimmarrje që ne kemi përmendet se jemi në fushatë se vijmë zgjedhjet në 2025. Tani ne dimë të kryejmë detyrën, tani për këtë jemi këtu të kemi vendimmarrje, nëse tani do të ndajmë mendime juridike dhe pa vendimmarrje nuk besoj që funksionon kështu këshilli bashkiak. Kështu që, në lidhje me pjesën e fushatës ke të drejtë. E di ku do të ndikojë më shumë zoti Burgija? Do të ndikojë më shumë, sepse do të jetë më e lehtë për ne, për të vetmen arsye do të jetë më e lehtë, sepse qytetari po u kënaq nga shërbimi që merr në një institucion shtetëror, foli sa të duash, bëji ndërhyrje sa të duash, dhe po ta them unë e para jam, që nuk ndryshoj mendim. Kështu që sinqerisht ju them, e përsëris, jo për të demoralizuar askënd, asnjë forcë politike, por mendojeni pak më qetë, pak më gjerë.

**Hekuran Markola :** Mos i mëso.

**Jonida Musaraj:** Do i mësoj. Faleminderit.

**Ani Dyrmishi:** Faleminderit.

Po zoti Laçi,

**Erzen Laçi:** Në lidhje me këtë çështje absolutisht që ka të bëjë edhe me procesin zgjedhor të 2025, unë kam fakte në zonën time elektorale, ku dhe ju drejtoni zoti kryetar, por njëkohësisht edhe bashkëpunotorët e tu më të afërt, që nuk kanë lidhje as me hipotekën, as me aluizmin, kanë hapur zyra normalisht, jo si me thënë të licensuar nga pushteti, por zyra private ku kontaktojnë votuesit dhe i marin çertifikatat e pronave, e përshpejtojnë ndoshta brenda ligjit, por ç'rëndësi ka kundrejt votës dhe kjo ndikon drejtëpërdrejtë në zgjedhje. Këtu e kundërshtoj zonjën Musaraji, madje mund të jetë një lloj personi që e njuh shumë mirë znj.Musaraji, kush i bën këto lëvizje nëpër fushata, absolutisht ndihmohen njerëzit, sepse duket si një ndihmë e vogël dhe vihen përpara faktit që do të votojnë.

Pastaj për zotin Markola, nuk është problemi te 2025, qytetarët e Durrësit e dinë kë do të votojnë. Me zgjidh punën kë me votuar qytetarët e Durrësit, ka zonja dhe burra shumë të mirë këtu, por Markolën s'besoj ta votojnë.

**Markola:** Nuk jam kandidatë.

**Erzen Laçi:** Po dhe ti anëtar i këshillit bashkiak je, ty s'të voton kush.

**Ani Dyrmishi :** Për replikë zonja Musaraj.

Vetëm 2 minuta.

**Jonida Musaraj:** Atëhere, zonja Musaraji vjen nga bota akademike të them të drejtën dhe ndoshta dhe aq mirë nuk i di, ato që ju pretendoni që unë i di, po di të them diçka që : “Unë jam qytetare e Durrësit si dhe ju dhe marr po të njëjtat shërbime si dhe ju”, kështu që dhe vlerësimet mundohem të jem shumë objektive kur i bëj. Unë mund të jem ke ky mandat anëtare këshilli dhe ke mandati tjetër mos të jem fare, por qytetare e Durrësit do vazhdoj të jem. Kështu që shumë faleminderit.

**Ani Dyrmishi:** Faleminderit.

z. Burgija, replikë.

**Dritan Burgija:** Zonja Musaraji, ju falenderoj për ndërhyrjen.

Dy janë gjonat, ose nuk e njeh fushatën, ose nuk jeni marrë ndonjëherë me fushatë, ose pastaj me një fjalë bën siç bëjnë të gjithë kolegët tuaj këtu, që mbajnë të njëjtën qëndrim dhe nuk pres gjë tjetër, nuk presim gjë tjetër nga ju.

Që të thuash sot që legalizimet janë, kanë fillu kalin e betejës Partia Socialiste në 2019 dhe vazhdojnë prap të thithin votë me çështjen e legalizimeve, kjo është naive.

Tashi do më bësh të listoj këtu gjithë listën me çfarë bëhet fushata e Partisë Socialiste. Ne shkojmë me fjalë, ju shkoni me legalizim, ne shkojmë me fjalë, ju me administratë, ne shkojmë me fjalë ju shkoni me 50.000 lekëshat e pensionistëve, që mendoni që po gënjeni njerëzit pas 12 vjetësh. Ka një listë të gjatë, që mund ta përmend këtu në përgjigje të fjalës suaj zonja Musaraji.

Gjithsesi unë e mbyll fjalën time edhe nëse më do përmendni prap nuk do kthej më përgjigje. Faleminderit.

**Joniada Musaraj :** Jo nuk do të përmend.

**Ani Dyrmishi:** Faleminderit.

Atëhere pyetje tjetër përsa i përket pikës, s'besoj se ka?!

**Rolant Xhelilaj:** Ta bëj unë një koment?

**Ani Dyrmishi:** Po, zoti Xhelilaj.

**Rolant Xhelilaj:** Çdo këshilltar ka të drejtë të japi opinionin e tij. Në fakt zoti Burgija mbajti qëndrim në grup edhe Joni mbajti qëndrim në grup. Po qe pastaj për të folur edhe me emra, edhe me mënyra veprimi, edhe me letra të shpërndara, historitë janë pafund për kohën tuaj dhe nuk janë për kohën tonë. Sado mundoheni, Erzeni bën përpjekjen e vet patjetër, partitë ke zona së tij s'ka dhënë efekt kjo....

**Ani Dyrmishi:** Mos t'i hym kësaj të lutem, se s'dalim më.

**Rolant Xhelilaj:** Po ka qëndrim grupi, grupi vendos që ta miratojë ose jo. Gjithë komentet pastaj, lista e gjatë e premtimeve, o zot i madh po t'i hapësh pastaj premtimet e forcës politike, kemi dëgjuar idiotësira dhe jo premtime. Megjithatë, njerëzit në fund vendosin në raport me atë që marrin, me shërbimin, me vëmëndjen, me realizimin e detyrave.

**Ani Dyrmishi:** Atëherë kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 2 të rendit të ditës?

Kundra?.....

Abstenim? .....Nuk ka.

Ju lutem ngrihni dhe njëherë kundër.....1,2,.....8, 9.

Atëhere, me 25 pro, 9 kundra, miratohet pika 2.

- Kalojmë **në diskutim**. E ka kërkuar fjalën Jonuz Myshketa, dhe më pas përgatitet Anisa Ibraj.

**Jonuz Myshketa:** Zonja kryetare dua t'iu paraqes shqetësimin e disa banorëve të lagjes nr. 1, të cilët kanë që prej vitit 2015 që ankohen në lidhje me rrugën ku ata banojnë dhe kalojnë. Praktiksht rruga, “Hysen Matlia” bashkë me rrugën “Anastas Durrsaku” dhe këtu kam dhe referencat, diku tek Vila e Zogut, karshi Kishës Ortodokse. Banorët kanë paraqitur kërkesa përgjatë vitit 2015, 2020 2021 dhe rishtaz më datë 7 gusht, kanë paraqitur një kërkesë të tyre, të cilët bëjnë me dije problematikat që kanë për këtë rrugë, është problem për lëvizjen e tyre qoftë në këmbë, qoftë me automtjet e tyre, të cilët po i demulohen për shkak të mos zgjidhjes së kësaj ankese që kanë. Do iu lutesha të merrej një masë imediate, besoj që jeni në dijeni të faktit. Janë 10 familje, por qoftë dhe një familje ne kemi detyrim të ngrejmë shqetësimet dhe bashkia të japi shërbimin e munguar. Këtë kisha pyetjen e parë. Mund të vazhdoj me të dytën apo..?

**Ani Dyrmishi:** Mund të vazhdosh, bëje dhe të dytën.

**Jonuz Myshketa:** Pyetja tjetër që kam është për gjimnazin Gjergj Kastrioti në Durrës. Është zbuluar rishtazi një sit arkeologjik dhe për këtë dua të përgëzoj, kush e ka zbuluar dhe për mirëmbajtjen dhe për hapjen, të paktën në këtë rast nuk u përsërit si rastet e kaluara, siç flasim për Velierën në fjalë, ku rrënojat arkeologjike të Durrësit u mbuluan me beton dhe të hapen, të mirëmbahen dhe pse jo të kthehen në një atraksion tjetër për Durrësin, si burim të ardhurash për turizmin dhe të mbajmë lart emrin e Dyrhut të vjetër.

Por pyetja ime, është me këtë gjinaz që ka 5 vite ku një brez është diplomuar, ka diplomën e saj Gjergj Kastrioti, por nuk ka vendndodhje. Kemi ndonë përgjigje në lidhje me: Se kur do bëhet, ku do bëhet? Sepse mendoj që ka qënë një nga gjimnazet, ku një pjesë këtu ka mbaruar në atë gjimnaz, duke kërkuar që bashkia dhe këshilli bashkiak të jetë pro nismës për të caktuar një vend ku duket më i përshtatshëm ose qoftë dhe një institucion, i cili nuk kryen funksionet e plota dhe të zhvillohet të vendoset realisht gjimnazi Gjergj Kastrioti.

Këto ishin 2 shqetësimet e mia. Faleminderit.

**Ani Dyrmishi:** Vazhdojmë me pyetjen e Anisës.

**Anisa Ibraj:** Përshendetje!

Në fakt unë dua të flas për një shqetësim për nxënësit e shkollës “Shefqet Ndroqi” Romanat, prindërit janë të shqetësuar se fëmijëve të tyre nuk u paguhet më transporti duke qënë se ata janë me vendbanim larg shkollës dhe sipas VKM-së ata e plotësojnë kushtin me vendbanim mbi 2 km larg nga shkolla. Përveç këtij fakti, kjo zonë ka një infrastrukturë skandaloze duke qënë se nuk ka sinjalistika, trotuar, semafor, vija të bardha, etj. Gjithashtu shpejtësia e makinave që kalojnë në këtë aks, është jonormale duke rrezikuar jetën e fëmijëve. Në fakt janë 30 nxënës që duhet ta

përfitojnë transportin e paguar, dhe vlen për tu përmenduar që kanë disa ditë që nuk e frekuentojnë shkollën.

Unë kam dy pyetje: Pse nuk paguhet më transporti i nxënësve? Dhe a ka një projekt për realizimin e infrastrukturës në këtë zonë për fëmijët, që nuk përfitojnë transportin por duhet të ikin në këmbë në shkollë? Faleminderit!

**Emiriana Sako:** Atëherë po e nis nga këshilltari Myshketa. “Hysen Matlia” është një rrugicë në lagjen 1, përballë me kishën, ne kemi nisur që vjet, në fakt ka ardh një peticion nga banorët dhe kemi bërë verifikimet në vënd dhe e kemi nisur punën nga Ndërmarrja Rruga e Bashkisë Durrës, por rezultoi që kishte pretendime për prona private në zonë. Na u desh të bënim dhe këmbimin me ASHK-n dhe është një aks, i cili do bëhet me buxhetin e ndërmarrjes, pra me ndërmarrjen e bashkisë, pra nuk do dojë të bëhet një procedurë buxhetimi dhe prokurirmi. Kështu besoj që do marrim masa brenda këtij tremujori për ta sistemuar të gjithë zonën atje.

**Jonuz Myshketa:** Pra brenda tre muajsh do marrë zgjidhje ?

**Emiriana Sako:** Po besoj që po është kohë e mjaftueshme.

Në momentin që morëm një përgjigje që po është shtet e nuk është privat siç pretendonte zotëria, jemi duke bërë vlerësimin financiar.

**Jonuz Myshketa:** Përgjigja ka ardhur?

**Emiriana Sako:** Përgjigja po, që rruga është pronë shtet, se kishte pretendime për pronë private. Gjergj Kastrioti është një sfidë le të themi akoma për ne, aty janë gjetur nga gërryerjet arkeologjike ka pasur gjetje të jashtëzakonshme, një mozaik i shekullit të VI para krishtit i mirëmbajtur në gjendje optimale. Ka pasur 2, 3 tipe mozaiqesh, 700 monedha të gjetura atje, por dhe shtresëzime të qytetit që prej shekullit të VI para krishtit deri ne II apo të III pas krishtit.

Pra kemi të bëjmë me një aset të jashtëzakonshëm për qytetin tonë, të cilin duam patjetër ta vlerësojmë. Ende nuk është bërë miratimi nga KT-ja për rekomandimet e gjetjeve, pra grupi arkeologëve i cili është zgjedhur nga bashkia e Durrësit po bën raportin final, për ta dorëzuar KKTKM-ë, në Ministrinë e Ekonomisë Kulturës dhe Inovacionit për të marrë miratimet përkatëse. Në materialin paraprak nga biseda që kemi pasur dhe me arkeologët rezultoi, që një zonë e caktuar me një sipërfaqe relativisht më të vogël se sheshi, duke përjashtuar zonat e dy gjetjeve të cilat janë bërë në këtë zonë, mund të përdoret si objekt për shkollën. Dhe sigurisht që do të kemi një kufizim, le të themi, pra kemi shumë rregulla që na i cakton arkeologjia dhe gjetjet arkeologjike, por ajo që duam të bëjmë është që të konceptojmë shkollën bashkë me një muze të hapur në natyrë, që do të jetë një rast unik jo në Shqipëri por besoj në të gjithë...

**Jonuz Myshketa:** Shkolla do të ndërtohet po aty?

**Emiriana Sako:** Ne do të, mbas miratimit nga KKTKM-së do të marim sitin, të cilët arkeologët na e kanë lënë në dizpozicion dhe do të bëjmë një ushtrim për të kompozuar atje objektin e

shkollës duke mbajtur në konsideratë elementët e numrin e nxënësve që kanë apo klasat që duhen dhe do shohim a arrijmë dot të mbulojmë kërkesën e këtij gjimnazi në atë territor. Por kjo do të bëhet, do të fillojë mbas miratimit të KKTKM-së, sepse sigurisht duhet një material zyrtar për të bërë fillimin e këtij procesi për...

**Jonuz Myshketa:** A ka kohë?

**Emiriana Sako:** Besoj që ato në muajin tetor do të bëjnë dorëzimet e materialit, sepse kanë kërkuar dhe një gërmim tjetër arkeologjik, pra do të bëjnë dhe një sondazh të tretë, për të qenë të sigurt që ky territor që kanë lënë të lirë, për mundësinë e ndërtimit të shkollës, mos të ketë gjetje të tjera nëntokë, pra mos të vazhdojnë procesin e gërmimeve edhe pas. Kështu që besojmë do të kemi një përgjigje, tetor-nëntor do të kemi një orientim sesi do të vijojmë. Pastaj ne nuk na merr shumë kohë hartimi i projektit dhe financimin ose do ta bëjmë me qeverinë, ose do ta buxhetojmë me buxhetin tonë. Plotin në dispozicion të projektit e cakton arkeologu, pra ne nuk kemi plotin që kishim përpara gërmimit arkeologjik.

**Jonuz Myshketa:** Përpara para se të fillonin gërmimet, ka pasur projekt.

**Emiriana Sako:** Patjetër, po ai ka rënë poshtë komplet, sepse në themelet e atij projekti kemi sot mozaikun.

**Jonuz Myshketa:** Pra, do bëhet në një të ardhme të afërt dhe do të ndryshohet projekti, okej(okay).

**Emiriana Sako:** Nga pritshmëritë që kanë arkeologët aty nuk ka më vazhdimësi siti, pra vazhdimësi mund të ketë nga ana e kodrës, jo nga ana e sheshit dhe kanë dhe një kusht për gërmimet nën 6 metra, pra nëse nuk gërmohet nën 6 metra nuk rrezikohet asnjë lloj monumenti arkeologjik.

Shkolla e Romanatit është një problematikë që na ka ardhur dhe nga prindërit, i jemi drejtuar Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, pasi Auditet dhe rekomandimet e tyre na kanë lënë që zbatimi i VKM-së, duhet bërë, pra në kushtet që nëqoftëse ka fshatra, të cilat kanë shtrirje edhe mbi 2 km nuk duhet paguhen nxënësit, kemi kërkuar që të ndryshohet kjo me Vendim të Këshillit të Ministrave dhe besoj që do kemi një ndryshim të menjëhershëm të rimbursimit të prindërve.

Pra ne kemi folur dje me ministren se e kishim në Durrës në një inagurimin e një shkolle të re dhe mendoj se do marrim zgjidhje shpejt. Më tej do vijojmë procedurat për të ndryshuar VKM-në, sepse ka shumë fshatra në Durrës, por patjetër në të gjithë Shqipërinë, ku distancat janë mbi 2 km dhe je po brenda të njëjtës fshat, siç është rasti Romanatit, por dhe Ishmi e ka të përsëritur të njëjtën problematikë.

Më tej pastaj pjesa e infrastrukturës është puna jonë e përhershme, pra pothuajse çdo vit vendosim sinjalistikën dhe mirëmbajmë vijëzimin e infrastrukturës arsimore. Kështu që...

**Anisa Ibraj :** Po për shtrimin e rrugës.



**Emiriana Sako:** Ajo është një rrugë nacionale, pra nuk është një rrugë e Bashkisë së Durrësit, dhe investimi.....

**Anisa Ibraj :** Dhe kur ne nuk i zgjidhim dot gjërat, themi që nuk janë në kompetencat tona.

**Emiriana Sako:** Të kam kthyer dhe një përgjigje tjetër për këtë, sepse kur nuk është kompetencë ime nuk më lejon ligji, nuk më lejon ligji që ta bëj unë atë gjë.

**Anisa Ibraj :** Don apo nuk do këtë se dimë.

**Emiriana Sako:** Jo unë dua po, s'është kompetencë e imja. Dhe gjithsesi nuk më le të mbaroj. Kjo rrugë është futur në prioritet e Qeverisë Shqiptare dhe paralel me autostradën Tiranë - Durrës, do të filoj dhe aksi i rrugës së Ndroqit, që nga Tirana, duke nisur nga Tirana për të ardhur deri në Durrës. Shumë faleminderit.

**Ani Dyrmishi:** Faleminderit Ju.  
Mbledhjen e deklaroj të mbyllur.  
Për mbledhjen e radhës do të njoftoheni nga Sekretaria.

*Ky procesverbal mbyllet me nr. rendor 17 (shtatëmbëdhjetë) faqe, i cili pasi verifikohet firmoset nga kryetari i këshillit, sekretari i këshillit dhe 3(tre) këshilltarë.*

**Mbajtësi i procesverbalit:** Enxhi Gjuzi

**Komisioni i Verifikimit të Procesverbalit :**

Kryetar i Këshillit Bashkiak :

ANI DYRMISHI

Sekretar i Këshillit Bashkiak :

DORINA MILJA

Zëvendëskryetar i Këshillit :

DENISA LUARASI

Zëvendëskryetar i Këshillit :

EDLIRA DEVOLLI

Kryetar i Gr. Këshilltarëve Demokrat :

DRITAN BURGJIA